



Planuar / Dorezuar Prijmjen/Prodato Received/Delivery	07-05-2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtjaja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBICK	2288/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 202/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Arben Mehmeti-Kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 202/2021, të datës 30.03.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Lagja e Spitalit „rruga Ukshin Kovacica“, pa numër nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike “vërejte me shkrim”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.202/2021, e datës 30.03.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet, vërejtja e datës 10.03.2021, për mes e-mailit të shqiptuar nga Drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 30.03.2021, me numër protokollit 1474/2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të Kosovës me pretendimet ankimore së Drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, i ka shqiptuar vërejtje me shkrim përmes e-mailit të datës 10.03.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 02.04.2021, me numër protokollit 1601/2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e

Drejtësisë ndërsa me datë 12.04.2021 me numër protokoll 1727/2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Drejtësisë, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.202/2021 e datës 30.03.2021, me numër protokoll 1474/2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ,e-maili i datës 12.03.2021,i konkurs;e-maili i datës 01.04.2019,i Formulari i vlerësimit të rezultateve në Punë, për Formulari i vlerësimit të rezultateve në Punë, për vitin 2019,Akt Emërimi i datës 24.04.2017, i vërejtja e datës 10.03.2021.e Drejtorit të Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, për Përgjigje në ankesë e datës 12.04.2021, me numër protokoll 1727/2021, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, *është e bazuar ,SEPSE:*

Bazuar në ankesën e ankueses e cila pretendon se Drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar i Ministrisë së Drejtësisë, si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ka shqiptuar vërejtjen më datë 10.03.2021,përmes e-mailit,në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, prandaj Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet ankimore të ankueses sa i përket vërejtjes me shkrim, të shqiptuar nga Drejtori si mbikëqyrës i Drejtpërdrejtë dhe duke u bazuar në provat e administruara në lidhje me këtë lëndë, ka konstatuar se perëndimet ankimore të ankueses janë të bazuara dhe në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankuesja pretendon se masa disiplinore e kundërshtuar nuk përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ sipas nenit 47 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 dhe nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-131 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe depozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si ligj i aplikueshëm, respektivisht nenin 45 paragrafi 1,nënparagrafet 1.1,1.2,1.3,1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili ka përcaktuar se :1. **përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.**

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji ka analizuar dispozitat nenit 48, paragrafi 1 dhe, nen paragrafi 1. 2 Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se; 1. **Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;** Andaj bazuar në këtë përcaktim ligjor, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen

e Ankesave vlerëson se vërejtja me shkrim e ankuese e shqiptuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, është dhënë pas një arsytim të artikuluar, e që pretendimi ankimor i ankuses në këtë kuptim është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i ankuses vërejtjen e ka dhënë duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi 1 të Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, mirëpo vërejtjen me shkrim e ka bërë vetëm përmes e- mailit, e jo në formë të shkruar, verbale, e që në këtë formë nuk parasheh të drejtën që të atakohet kjo formë e vërejtjes andaj kolegji konstaton se vërejtja është dhënë në kundërshtim me nenin 47, paragrafi 1, si dhe nenin 48, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se; **1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, si dhe nenin 8, paragrafi 1,2 Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se; 1. Ndaj nëpunësve civil, zbatohen masat e përcaktuara në nenin 47 të Ligjit. 2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuar në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit.**

Organi i punësimit Ministria e Drejtësisë, është e obliguar që pas këtij vendimi të Këshillit, të ndërmarrë veprimin që nga dosja e ankuses të largohet vërejtja e datës 10.03.2021, përmes e- mailit e shqiptuar nga Drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, duke vepruar në pajtim me Ligjin nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr. 202/2021, datë 07/05/2021

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankueses
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Drejtësisë;
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

